



FTESE PËR PJESËMARRJE

NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR “VINITALY 2026”, 12- 15 Prill 2026 VERONA, ITALI

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të pjesëmarrjes në Panairin Ndërkombëtar “Vinitaly 2026” në edicionin e 58-të të tij, në datat 12 - 15 Prill 2026, në Verona, Itali, Ju fton të bëheni pjesë e standës së Ministrisë.

Ky është një panair i mirënjohur për profesionistët në industrinë e verës, duke përfshirë prodhuesit, shpërndarësit, blerësit dhe somelierët e verës. Panairi ofron një gamë të gjerë verërash nga e gjithë bota, me ekspozuesit që prezantojnë produktet e tyre. Vinitaly ofron një platformë unike për rrjetëzimin e biznesit, ndarjen e njohurive dhe analizën e tendencave të tregut. Pjesëmarrësit mund të marrin pjesë në degustime, seminare dhe aktivitete të tjera, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve të verës, si ato të zhvilluara ashtu edhe ato në zhvillim.

Ftojme të gjitha kompanitë që i përkasin kategorisë së sipërpërmendur, të cilat kanë mundësi dhe sasi eksportuese, të marrin pjesë duke na dërguar me e-mail një prezantim të shkurtër të kompanisë, si dhe kapacitetet eksportuese.

Nga eksperiencat e kaluara, disa prej subjekteve pjesëmarrëse në panair kanë shfrytëzuar mundësitë për të zgjeruar rrjetin e tyre dhe për të rritur biznesin ndërkombëtarisht. MBZHR këtë vit do të ketë dhe një hapësirë për një MASTERCLASS të dedikuar verërave shqiptare. Pjesëmarrja Juaj në këtë panair mbështetet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

*Për të siguruar pjesëmarrjen, lutemi të konfirmoni brenda datës **13.2.2026** në adresën info@bujqesia.gov.al.*

Në vijim, do t'Ju informojmë mbi detaje të mëtejshme rreth pjesëmarrjes Suaj në këtë panair.